

VENDIM
Nr.1479, datë 12.11.2008

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË KRYERJES SË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PËR
DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË TATIMEVE, SI AUTORITET KONTRAKTOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të përfundojë, brenda datës 29 dhjetor 2008, procedurat e prokurimit, për mallra e shërbime, me fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit të vitit 2008, sipas aneksit nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Brenda këtij afati përfshihet edhe lidhja e kontratave përkatëse.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ANEKSI 1

Procedurat që zhvillohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve janë këto:

1. Tenderi me objekt: “Mirëmbajtja e sistemeve informatike të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Qendrës Kombëtare të Regjistrimit”, me fond 75 708 000 (shtatëdhjetë e pesë milionë e shtatëqind e tetë mijë) lekë pa TVSH, është zhvilluar në datën 1.10.2008 dhe në datën 28.10.2008 është shpallur njoftim fituesi.

2. Tenderi me objekt: “Blerje *software* për rritjen e sigurisë së të dhënave të SIT dhe automatizimin e shkëmbimit të të dhënave”, i ndarë në lote, me fond 21.666.667 lekë pa TVSH.

Loti i parë: Sistemi i sigurisë së bazës së të dhënave (auditimi) - me fond 16.666.667 lekë pa TVSH;

Loti i dytë: Sistemi i automatizimit të shkëmbimit të të dhënave (Blerje *software* dhe implementim analiza e riskut), me fond 5.000.000 lekë pa TVSH.

Kjo procedurë është zhvilluar në datën 15.10.2008 dhe njoftim fituesi është shpallur në datën 29.10.2008.

3. Tenderi me objekt: “Blerja e sistemit informatik për menaxhimin e sistemit të pajisjeve fiskale në Republikën e Shqipërisë”, me fond limit 16.666 lekë pa TVSH, i pazhvilluar, bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.781, datë 14.11.2007 “Për karakteristikat teknike dhe funksionale të pajisjeve fiskale, sistemit të integruar të kompjuterizuar për transferimet periodike, automatike të deklarimeve financiare, sistemit të komunikimit, për procedurën dhe dokumentacionin për miratimin e tyre dhe për kriteret për pajisjen me autorizim të shoqërive të autorizuar për ofrimin e pajisjeve fiskale”, si dhe kontratën e shkruar nga Ministria e Financave dhe shoqëritë e autorizuar, neni 3 pika II germa “d”.

4. Tenderi me objekt: “Blerje karburanti”, me fond limit: 21.498.493 lekë pa TVSH, i zhvilluar në datën 3.9.2008, shpallur njoftim fituesi më 29.9.2008 ka ngelur pa shpallur njoftimi i kontratës së nënshkruar.

5. Tenderi me objekt: “Blerje orendi dhe pajisje zyre”, me fond limit 16.166.667 lekë pa TVSH, që është zhvilluar në datën 5.11.2008.

6. Tenderi me objekt: “Ruajtje objektësh”, për qarqet:

- Tiranë, me fond 2 069 928 lekë;

- Sarandë, me fond 804 972 lekë;
 - Kukës, me fond 1 034 964 lekë, është zhvilluar në datën 8.10.2008 dhe është shpallur njoftim fituesi në datën 24.10.2008;
 - Elbasan, me fond 1 494 948 lekë;
 - Lezhë, me fond 1 034 964 lekë, pa zhvilluar për dy qarqet pasi është anuluar.
- Fondi limit në total i tenderit me objekt: “Ruajtje objektesh” është: 6 439 776 lekë pa TVSH.
7. Tenderi me objekt: “Riparim automjetesh”, me fond limit 3 501 000 lekë pa TVSH është zhvilluar në datën 24.9.2008 dhe është shpallur fituesi në datën 23.10.2008.